



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
TIRANE

Nr. 478 Akti  
Dt.21.03.2019

Dt.23.03.2019

V E N D I M

“Për vlerësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit për qëllim ekstradimi”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga

**GJYQTAR GERD HOXHA,**

asistuar nga sekretare gjyqësore **Znj.Silvi Xhakolli**, sot në Tiranë, më dt.23 mars 2019, mori në shqyrtim kërkesën penale që i përket :

KERKUES:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar nga prokurori **Z.Besnik Cengu**.

SHTETASIT :

**Hiteshkumar Patel**, i biri i Bulakhidas dhe i Nerndarabiai, i dtl.19.08.1960, lindur në Gujarat Indi dhe banues në Lagos, Nigeri, me shtetesi Indiane, i martuar me 2 fëmijë, i padënuar, në prani të përkthyeses **Znj.Enkela Xhamaj**, i mbrojtur nga **Av.Xhevahir Morina dhe Av.Artjan Bejo**.

OBJEKTI:

Vlerësimin si të ligjshëm të arrestit të përkohëshëm me qëllim ekstradimi dhe caktimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*”.

BAZA LIGJORE :

Nenet 228, 229, 244, 244, 245, 259, 494, 495 të K.Pr.Penale, Ligji “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, “Konventa e OKB kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”, ratifikuar me ligjin nr.8920, dt.11.07.2002.

Gjykata pasi administroi aktet shkresore, dëgjoji kërkesën e prokurorit, i cili kërkoi vlerësimin si të ligjshëm të arrestit të përkohëshëm dhe caktimin e masës së sigurimit personal "arrest në burg" për personin nën hetim Hiteshkumar Patel;

dëgjoji personin nën hetim Hiteshkumar Patel dhe mbrojtësit e tij, që nuk e pranuan akuzën e ngritur; e lanë në çmim të Gjykatës vlerësimin si të ligjshëm të arrestit të përkohëshëm dhe kërkasun caktimin e një mase sigurimi më të butë ;

## V Ë R E N

Se, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë është sjellë për gjykim kërkesa për vlerësimin si të ligjshëm të arrestit të përkohëshëm dhe caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg" ndaj personit nën hetim Hiteshkumar Patel.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se, më dt.20.03.2019, ora 17:25", policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë Rinas, gjatë poërpunimit të pasagjerëve të linjës ajrore "Charter", Tiranë - Dubai ka bërë arrestimin e shtetasit indian Hiteshkumar Patel. Ky arrestim është bërë në zbatim të urdhërit të arrestit ndërkombëtar, lëshuar më dt.25.01.2019 nga Gjykata e Sh.atish Kumar Arora, të gjyqtarit të seksioneve -02 Gjykata Patiala House, Neë Delhi, Indi. sipas këtij urdhër arresti rezulton se, shtetasi Hiteshkumar Patel është person nën hetim për kryerjen e veprës penale të "Pastrimit të parave", në bashkëpunim me shtetas të tjerë, parashikuar nga nenet 3 dhe 4 të ligjit indian "Për parandalimin dhe pastrimin e parave" të vitit 2002, për të cilën parashikohet një dënim deri në 7 (shtatë) vjet burgim.

Me shkresën nr.343/1prot/E.B, dt.21.03.2019 Drejtoria Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë (më poshtë DMJJ) në Prokurorinë e Përgjithëshme Tiranë i ka kërkuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë kryerjen e veprimeve përkatëse, duke proceduar fillimisht me kërkesën për vlerësimin e ligjshëm të arrestimit të përkohëshëm nga policia gjyqësore e më pas atë të caktimit të masës së sigurimit "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Kjo shkresë shoqërohet nga njoftimi i ZQKI; proces-verbali i arrestimit të përkohëshëm dhe kontrollit dt.21.03.2019; proces-verbal dt.20.03.2019 për marrje të dhënash nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime; proces-verbal sekuestrimi i pasaportës nr.K1996441 në emër të shtetasit indina Hiteshkumar Patel; kartela e të dënuarit; urdhëri i arrestit ndërkombëtar (red notice) në shqip dhe origjinali në anglisht, shkurtim vendimi në gjuhën indiane, etj...

Sipas përshkrimit të bërë në praktikën e dërguar nga ZQK Interpol Tirana (urdhër arrestit ndërkombëtar - kartela e kuqe, raport individual, etj...) rezulton se, për këtë shtetas është bërë kërkesë për arrestimin ndërkombëtar nga autoritetet e drejtësisë Indiane, kartele e kuqe me numër kontrolli Nr.A-2818/3 – 2019 – Reg. Urdhër arresti dhe fotografia e personit ndodhen bashkëlidhur për referencë. Sa më sipër kërkohet që personi të arrestohet pas identifikimit të identitetit të tij dhe të informohet ZQK (autoritetet e drejtësisë Indiane), me qëllim që dokumentat e ekstradimit të dergohen tek autoritetet shqiptare nëpërmjet kanaleve diplomatike, për ekstradimin e këtij personi në Indi.

Sipas raportit Individual numer i dosjes per shtetasin Indian të mësiperm është 2019/26753, data e lindjes 19.09.1960 origjina e ZQK-se, ZQK Nju Delhi Indi. Sipas këtij Raporti Individual ne numerin e dosjes së mësiperme me datë publikimi 11.03.2019 të interpol karte e kuqe i arratisuri kërkohet për ndjekje penale sipas informacionit plotësues date 31.08.2017 të Drejtorisë së Përmbarrimit Nju Delhi, pasi është marrë për hetim sipas aktit "Për parandalimin dhe pastrimin e parave" te vitit 2002 kunder Sterling Biotech Limited dhe etj, pasi gjate hetimeve eshte zbuluar se fondet e huave ishin marre nepemjet aktivitetit kriminal dhe pastruar nepemjet shtresave te ndryshme per perfitim te nxitesve . Ne kete menyre shumate e perfshira ne pastrimin e parave ne turne, jane mbajtur perkohesisht nga Drejtoria e Përmbarrimit.

Gjithashtu nje ankese e Prokurorise në çeshtjen ECIR /HQ/2017 duke e vendosur z. Hiteshkumar Patel dhe te tjere si te akuzuar eshte dorezuar ne Gjykatën e Seksionit Shtese, Gjykata Patiala House, Nju Delhi me 23.10.2018 .

Gjykata ka leshuar Urdher arrestin date 25.01.2019 ndaj Hiteshkumar Patel dhe hetimet lidhur me kete ceshtje vazhdojne. Eshte identifikuar me dokument identiteti pasaporte etj...Sipas këtij raporti shtetasi indian i mësiperm dhe disa persona te tjere shtetas indian janë të perfshire në veprat penale të "Pastrimit të parave" të parashikuar nga nenet 3 dhe 4 te Ligjit "Per parandalimin dhe pastrimin e parave" te shtetit indian dhe nenet 120-B, 420, 467, 468 dhe 471 te Kodit Penal Indian i vitit 1980 dhe seksioneve 13/2 dhe 13/1 d te aktit "Per parandalimin e korrupsionit" te vitit 1988 ndaj disa personave duke u perfshire shtetasi i mesiperm dhe disa shtetas te tjere nga India.

Prokuroria pretendon se, keto vepra penale parashikohen edhe ne KP të RSH e konkretisht ne nenin 287 "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale" etj...

Data e leshimit te urdher arrestit eshte me date 25.01.2019. Autoritetet e drejtesise Indiane kane deklaruar se ne rast te gjetjes se personit te arrestohet per ta ekstraduar dhe pas arrestimit garantohet se do te kerkohej ekstradimi, ne perputhje me ligjet kombetare dhe traktatet e aplikueshme dy dhe shume paleshe.

Kjo kerkese duhet te trajtohet si kerkese formale per arrestim te perkohshem ne perputhje me ligjet dhe traktatet dy dhe shume paleshe. Kerkesa per arrestimin e perkohshem per efekt ekstradimi ne shtetin Indian te shtetasit te mesiperm bazohet ne ligjin nr.8920 dt.11.07.2002 "Per ratifikimin e konventes se kombeve te bashkuara kunder krimin te organizuar nderkombetar" dhe 2 protokolleve shtese te saj. Ne nenin 16 te kesaj konvente qe ben fjale per ekstradimin sipas te cilit ky nen do te aplikohet ndaj veprave penale qe mbulohen nga kjo konvente ose, ne rastet kur nje veper penale qe permendet ne nenin 3 paragrafi 1 a) ose b) perfshin nje grup kriminal te organizuar dhe personi i cili eshte subjekt i kerkeses per ekstradim ndodhet ne shtetin pale te kerkuar me kusht qe vepra penale per te cilen kerkohej ekstradimi te jete e ndeshkueshme ne baze te legjislacionit te brendshem te shtetit kerkuar dhe te kerkuar.

Pika 4 e nenit 16 citon se "Ne qofte se nje shtet pale qe e kushtezon ekstradimin me ekzistencen e nje traktati mer nje kerkese per ekstradim nga nje shtet tjetër pale me te cilen nuk ka lidhur ndonje traktat mbi ekstradimin, ai mund ta konsideroje kete konvente

si bazen ligjore per ekstradimin ne lidhje me cdo veper penale ndaj te ciles aplikohet ky nen.

Prokuroria pretendon se, kjo konvente e ka parashikuar penalizimin e parave te ardhura nga krimi, eshte ratifikuar nga shteti Shqiptar si konvente nderkombetare dhe plotesohen te gjitha kushtet ligjore per te vendosur nje mase shtrënguese siç eshte ajo e "arrestit në burg" parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale ndaj shtetasit indian te mesiperme per efekt ekstradimi.

Per arsyet e mesiperme, bazuar ne Ligjin Nr.8920 date 11.07.2002 "Per ratifikimin e "Konvetes se Kombeve te Bashkuara kunder krimin te organizuar nderkombetare" dhe dy protokolleve shitesë të saj, nenit 31 e vijues te ligjit Nr.10193 date 03.12.2009 "Per marrredheniet juridiksionale me autoritetet e huaja ne ceshtjet penale" si dhe nenet 493,494 dhe 495 pika 2 dhe 3 te K.Pr.Penale dhe nenet 228, 244 dhe 238 te K.Pr.Penale, prokurori kërkoi nga Gjykata miratimin dhe vlerësimin si të ligjshëm të arrestimit të bërë më dt.20.03.2019 nga OPGJ dhe caktimin e masës së sigurimit "arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale të RSH, ndaj shtetasit indian Hiteshkumar Patel, në pritje të kërkesës me qëllim ekstradimin e tij në shtetin indian.

Gjatë seancës gjyqësore për miratimin dhe vlerësimin e kësaj kërkesë, Gjykata procedoi me identifikimin dhe pyetjen e këtij shtetasi, i cili u asistua nga një përkthyesë e gjuhës angleze, pasi shtetasi në fjalë, bazuar në dokumentin zyrtar të ardhur nga autoritetet indiane dhe pohimin e tij para Gjykatës, njihte gjuhën angleze.

Për të garantuar mbrojtjen e kërkuar nga neni 495 e 496 të K.Pr.Penale Gjykata procedoi me legjitimin e dy mbrojtësve, të zgjedhur nga djali i të arrestuarit Hiteshkumar Patel, të cilët u pranuan edhe nga vetë i arrestuari.

Nga verifikimi i identitetit të personit të arrestuar rezultoi se, ai ishte pikërisht shtetasi indian **Hiteshkumar Patel**, i biri i Bulakhidas dhe i Nerndarabiai, i dtl.19.08.1960, lindur në Gujarat Indi dhe banues në Lagos, Nigeri, me shtetesi Indiane, i martuar me 2 fëmijë, i padënuar.

Pasi dëgjuan kërkesën e prokurorit mbrojtja dhe personi nën hetim Hiteshkumar Patel e lanë në çmim të Gjykatës vlerësimin e ligjshëm të arrestit por, kërkuan caktimin e një mase sigurimi më të butë : "detyrim paraqitje në polici gjyqësore" apo "arrest në shtëpi". Mbrojtësit pretenduan se, i arrestuari përndiqet nga shteti indian për shkak të bindjeve të tij fetare dhe politike, duke iu referuar lidhjeve familjare të tij me familjen indiane Sandesara dhe sepse është i afërm i kryetarit të opozitës indiane. Ai pretendoi se, ky fakt është njohur edhe një Gjykatë e Lartë në Nigeri, vendi ku ai është aktualisht rezident, e cila nuk ka lejuar arrstimin apo/dhe ekstradimin e tij. Sa i përket veprës penale, ai e konsideron një marrëdhënie juridiko-civile dhe jo vepër penale. Gjithashtu, mbrojtësit pretenduan një masë më të butë nisur edhe nga gjendja shëndetësore jo e mirë e të arrestuarit.

Bazuar në sa më sipër, mbrojtësit e të arrestuarit kërkuan mosmarrjen e asnjë mase sigurimi, bazuar në parashikimet e pikës 3 të nenit 493 të K.pr.Penale sipas të cilit parashikohet se : "Masat shtrënguese dhe sekuestroja nuk vendosen kur ka arsye të çmohet se nuk ekzistojnë kushtet për dhënien e një vendimi në favor të ekstradimit."

Për të vërtetuar këto fakete, i arrestuari paraqiti disa dokumenta por, jo në formën e kërkuar nga ligji procedural penal shqiptar (nuk ishin të legalizuara konform Konventës së Vienës të viti 1961).

Lidhur me sa më sipër Gjykata vëren se, kushtet ligjore për vlerësimin e ndalimit/arrestimit për qëllime ekstradimi janë të parashikuara nga neni 495 në lidhje me Titullin V, nenet 228 - 260 të K.Pr.Penale të Republikës së Shqipërisë. Sipas këtyre kushteve ndalimi (*apo arrestimi në rastin konkret*) i një të dyshuari për krim mund të urdhërohet nga prokurori vetëm nëse:

- ka shkaqe të bazuara për të menduar se i dyshuari për një krim ka rrezik ikjeje;
- për veprën për të cilën dyshohet personi, ligji cakton një dënim me burgim jo më të ulët në maksimum se katër vjet.

Gjykata vëren se, ligji kërkon që, të dy këta kushte duhet të ekzistojnë njëkohësisht përndryshe, nuk mund të vendoset ndalimi ndaj të pandehurit (*person nën hetim*) për një krim.

Në rastin konkret, Gjykata vëren se, personi nën hetim Hiteshkumar Patel është kapur disa muaj pas kryerjes së veprës penale, për të cilën ai dyshohet se e ka kryer. Dyshimet bazohen në urdhërin e arrestit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet gjyqsore indiane si dhe kërkesën e ZQK Interpol India, për caktimin e një masës shtrënguese "arrest në burg". Gjithashtu Gjykata vëren se, për kryerjen e veprës penale të "*Pastrimit të parave*", në bashkëpunim me shtetas të tjerë, parashikuar nga nenet 3 dhe 4 të ligjit indian "*Për parandalimin dhe pastrimin e parave*" të vitit 2002, nenet 120-B, 420, 467, 468 dhe 471 të Kodit Penal Indian i vitit 1980 dhe seksioneve 13/2 dhe 13/1 d të aktit "*Per parandalimin e korrupsionit*" të vitit 1988, për të cilën parashikohet një dënim deri në 7 (shtatë) vjet burgim.

Sa më sipër Gjykata çmon se, në vështrim të nenit 253 të K.Pr.Penale të RSH, arrestimi (*ndalimi*) i personit nën hetim Hiteshkumar Patel është plotësisht i ligjshëm.

Lidhur me sa më sipër Gjykata vëren se, "*arrestimi në burg*" është një masë sigurimi personal e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale. Kjo masë sigurimi personal, sipas nenit 230 të K.Pr.Penale mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit. Kushtet dhe kriteret për vendosjen e masave të sigurimit personal janë të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale.

Sipas nenit 228 të K.Pr.Penal kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal janë :

- ekziston në ngarkim të të pandehurit (*apo personit nën hetim*) një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova – kusht themelor dhe një nga tre kushtet e mëposhtme :

1. ekzistenca e një shkakut të rëndësishëm që vë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës;
2. fakti se i pandehuri (*personi nën hetim*) është larguar ose, ekziston rreziku që ai të largohet;

3. për shkak të rrethanave të faktit dhe të personalitetit të të pandehurit (*personit nën hetim*) ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Sipas neneve 229 dhe 230 të K.Pr.Penale parashikohen kriteret e përgjithëshme dhe të veçanta, për caktimin e masave të sigurimit. Ndërsa, neni 245 i K.Pr.Penale parashikon se, Gjykata mund të japë një masë sigurimi me afat për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës.

Në rastin konkret, Gjykata vëren se :

- ekziston dyshimi i arsyeshëm se, personi nën hetim Hiteshkumar Patel mund të ketë kryer veprën penale të « *Pastrimit të parave* », në shuma të mëdha, në bashkëpunim me persona të tjetër, parashikuar nga nenet 3 dhe 4 të ligjit indian « *Për parandalimin dhe pastrimin e parave* » të vitit 2002, nenet 120-B, 420, 467, 468 dhe 471 të Kodit Penal Indian i vitit 1980 dhe seksioneve 13/2 dhe 13/1 d të aktit « *Per parandalimin e korrupsionit* » të vitit 1988, për të cilën parashikohet një dënim deri në 7 (shtatë) vjet burgim. Dyshimi bazohet në urdhërin e arrestit ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet gjyqsore indiane, për caktimin e një masës shtrënguese « arrest në burg » njoftimi i ZQKI; proces-verbali i arrestimit të përkohëshëm dhe kontrollit dt.21.03.2019; proces-verbal dt.20.03.2019 për marrje të dhënash nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime; proces-verbal sekuestrimi i pasaportës nr.K1996441 në emër të shtetasit indiana Hiteshkumar Patel; kartela e të dënuarit; urdhëri i arrestit ndërkombëtar (red notice) në shqip dhe origjinali në anglisht, shkurtim vendimi në gjuhën indiane dhe në tërësi materialin procedues të sjellë për vlerësim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Fakti, të cilin dyshohet se ka kryer personi nën hetim Hiteshkumar Patel, parashikohet nga ligji si vepër penale me rrezikshmëri shoqërore të lartë, për të cilën, sipas ligjit indian parashikohet një dënim gjer në shtatë vjet burgim. Rrethanat e cituara më sipër mund ta shtyjnë personin nën hetim t'i shmanget hetimit dhe të largohet.
- Hiteshkumar Patel është në moshë relativisht të madhe Por, nuk u provua se, vuan nga ndonjë sëmundje veçanërisht e rëndë. Nuk është i alkoolizuar apo toksikoman, e për pasojë nuk është nën terapi mjekësore për këto shkaqe.

Sa më sipër Gjykata, në vështrim të neneve 495, 496 228, 229, 230, 244, 245, 253, dhe 259 të K.Pr.Penale, çmon se masa « *arrest në burg* », e kërkuar nga prokurori për personin nën hetim Hiteshkumar Patel, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të « *Pastrim parash* », në shuma të mëdha, në bashkëpunim, parashikuar nga nga nenet 3 dhe 4 të ligjit indian « *Për parandalimin dhe pastrimin e parave* » të vitit 2002, nenet 120-B, 420, 467, 468 dhe 471 të Kodit Penal Indian i vitit 1980 dhe seksioneve 13/2 dhe 13/1 d të aktit « *Per parandalimin e korrupsionit* » të vitit 1988 është në përshtatje me nevojat e sigurimit, rrezikshmërinë e faktit dhe të personit, i cili dyshohet se e ka kryer këtë vepër penale. Por, për të garantuar marrjen e provës së kërkuar nga i arrestuari dhe një proces të rregullt ligjor, brenda një afati të arsyeshëm sikurse sanksionon neni 6 i KEDNJ, masa e sigurimit do të jetë me një afat 40 ditor. Ky afat është në konformitet edhe e parashikimet

e pikës 6 të nenit 494 të K.Pr.Penale, që parashikon se, masat shtrëguesse revokohen nëse brenda tetëmbëdhjetë ditëve dhe gjithësesi në maksimum brenda dyzetë ditëve nga arrestimi nuk vjen në Ministrinë e Drejtësisë kërkesa për ekstradim dhe dokumentat bashkëngjitur asaj.

**PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, bazuar në nenet 244, 245 dhe 259 të K.Pr.Penale

**V E N D O S I**

1. Vlefesimin si te ligjshem te arrestimit per qellim ekstradimi te shtetasit indian **Hiteshkumar Patel, dtl.19.08.1960.**
2. Caktimin si mase sigurimi personal ndaj shtetasit **Hiteshkumar Patel**, i biri i Bulakhidas dhe i Nerndarabiai, i dtl. 19.08.1960 ate te **“arrestit ne burg me afat 40 ditor”**, te parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.
3. Ngarkohet Policia Gjyqesore per ekzekutimin e ketij vendimi.
4. Nje kopje e ketij vendimi t’i dergohet Ministrise se Drejtesise.
5. Shpenzimet proceduriale në shumën 5 000 (pesëmijë) lekë për përkthimin ne ngarkim të personit të arrestuar.
6. Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 5 (pesë) diteve ne Gjykatën e Apelit Tirane.

**U shpall në Tiranë sot, me 23 mars 2019!**

**SEKRETARE**

**SILVI XHAKOLLI**

**GJYQTAR**

**GERD HOXHA**